REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.783/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Zelfije Prekaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh. T. për shkak të veprës ale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së PPK në Pejë tani Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për krime të përgjithshme, PP.nr.2011/15 të dt.20.11.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Hoxha, të akuzuarit Xh.T., mbrojtësit të akuzuarit av.F. K. dhe në mungesë të dëmtuarve A. S. dhe B.B. me dt. 30.11.2015 mori dhe me dt.04.12.2015 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I akuzuari:

Xh. T, i biri i S. dhe nënës S. e vajzërisë M. i lindur me dt.... në Mitrovicë tani me banim në Rr.,,...'' i Ka të kryer shkollën ..., i...pa martuar , me profesion ... i gjendjes së ... ekonomike nr. personal ... shqiptar shtetas i R. Së Kosovës mbrohet në liri..

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 31.10.2015 rreth orës 22.03 min në Pejë rr."...", duke përdorë forcën pengon zyrtaret policor në kryerjen e detyrave zyrtare dhe at të dëmtuarit policët A. S. dhe B. B, në at mënyrë që, pasi i pandehuri Xh. kishte pas probleme me gruan e tij A. T. dhe e njëjta e kishte

lajmruar policin ku këta te fundit pasi kishin shkuar tek banesa e të dëmtuarës i pandehuri kishte filluar ti sulmoj me shqelma të dy policët ku më pas është arrestuar nga të njëjtit,

-me çka ka kryer vepër penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 7,28,41,42,49,50,51,52, neni 409 par.5 të KPRK-së,si dhe nenin 365 të KPPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarit të lartcekur i përcaktohet dënim me burg në kohë zgjatje prej 1 vjet e 6 muaj, ky dënim i përcaktuar nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda periudhës 2 vjeçare nuk kryen vepër të re penale.

Në këtë dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga dt.31.10.2015 e gjer me dt.30.11.2015.

Obligohet shërbimi s provues ta mbikëqyre të akuzuarin XH. T., gjatë tërë kohës së verifikimet nëse i akuzuari nuk bashkëpunon me shërbimin s provues, atëherë gjykata dënimin me kusht do ta revokoj dhe i njëjti do shkoj në vuajtje të dënimit.

I akuzuari obligohet qe në emër të shpenzimeve gjyqësore te paguaj shumën prej 60 dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 euro pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Palët e dëmtuara A. S. nga fsh. B. K. Pejë, dhe B. B. nga fsh. Ç. K.Pejë, udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

A r s y e t i m

Prokuroria Publike Komunale në Pejë tani Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.2011/15 të dt.20.11.2015, kundër të akuzuarit XH.T. për shkak të veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par.5 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit së shtetit PP.nr.2011/15 të dt.20.11.2015, në seancën e shqyrtimit fillestarë të mbajtur me datë 30.11.2015, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Në këtë rast gjykata ka udhëzuar të akuzuarin për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë i akuzuari Xh. T. ka deklaruar se i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe është i penduar për veprimet e tilla.

Prokurori deklaron se këto çka i ka deklaruar i pandehuri këtu i ka deklaruar edhe në polici dhe tek unë në prokurori, dhe konsideron se është pranim i sinqertë nga ana e tij, dhe i ka propozuar gjykatës ta pranoj fajësinë dhe ky pranim ti shërbej si rrethanë lehtësuese me rastin e vendosjes së vendimit mbi dënim.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre fakteve siç janë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit ,si dhe duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë; fotografit e vendit të ngjarjes dhe mjeteve të sekuestruara ; vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; raporti i oficerit A. S. dt.31.10.2015, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari është fajtorë për veprën penale të cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjatë shqyrtimit fillestar nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana për përjashtimin e përgjegjësisë penale të akuzuarit, andaj i akuzuari është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 par.1 të KPRK-së, kështu që si rrethana lehtësuese gjykata pati parasysh se i akuzuari e pranoj fajësin në seancën e shqyrtimit fillestarë dhe pati sjellje korrekte para gjykatës. Nga rrethanat rënduese gjykata nuk gjeti asgjë.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën

tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPK-së.

Gjykata konforn nenin 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e shpenzimeve procedurale.

Gjykata ka udhëzuar palën e dëmtuar në kontest civil konforn nenit 463 të KPRK-së.

Të akuzuarit Xh. T i ndërprehet paraburgimi arsyet për ndërprerje janë dhënë në aktvendimin e kësaj gjykate P.nr.783/15 dt.30.11.2015.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr. 783/15 dt. 04.12.2015.

Praktikantja gjyqësore
Ilirjana Zekaj

GJ Y Q T A R J A
Violeta Husaj – Rugova

KËSHILLA JURIDIKE:
Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar
ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita
e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,
e nëpërmjet të kësaj gjykate.